



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Fatmir Krasniqi	17.06.2025	19.06.2025	2025/0497

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 16.06.2025, OE “GETNO L.L.C.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/0497, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me AD-BLUE” me nr. të prokurimit: "TU-24-9473-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – N.P.K. " TRAFIKU URBAN " SH.A..Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, , lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 200,000.00 €. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, PSH; 2024/1228, dt.14.02.2025 dhe PSH; 2024/0202,dt 27.05.2025 .Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik

Neni 43 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

KRITERET PËR VLERËSIM

Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Raporti i rvlerësimit është ngrit në platëformën elektronike e-prokurimi me dt 29.05.2025

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

n/a

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

PSH; 2024/1228, dt.14.02.2025 dhe PSH; 2024/0202,dt 27.05.2025

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - GETNO L.L.C.

Sqarim Hyrës

Autoriteti Kontraktues – NPK "Trafiku Urban" Sh.a, gjatë këtij aktiviteti ka aplikuar procedurën e hapur, vlerë e madhe, lloji i kontratës furnizim, vlera e parashikuar 200,000.00€.

AK me dt. 11.09.2024 ka publikuar Njoftimin për kontratë ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt. 04.11.2024 dhe për këtë aktivitet prokurimi kishin aplikuar shtatë operator ekonomik në mesin e tyre edhe OE ankues

Autoriteti Kontraktues – NPK "Trafiku Urban" Sh.a me dt. 29.05.2025, pas ri-vlerësimit të tretë ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së duke anuluar në tërësi aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se nuk kanë pranuar oferta të përgjegjshme. Vlenë të ceket fakti se AK, respektivisht komisioni i vlerësimit dy herë radhazi ofertën e OE ankues e kishte rekomanduar për kontratë kurse me publikimin e njoftimit mbi vendimin e AK të datës 29.05.2025 e ka eliminuar me arsyetimin se nuk e keni dorëzuar sigurinë e tenderit përmes platëformës elektronike e-prokurimi por vetëm në formë fizike.

Kundër njoftimit mbi vendimin e AK, pala fillimisht parashtron kërkesë për Rishqyrtim tek AK me dt. 03.06.2025 brenda afatit ligjor. AK me dt.04.06.2025 nxjerr vendim mbi refuzimin e kërkesës si të pabazuar. OE i pakënaqur me vendimin e AK-së me dt. 09.06.2025 paraqet ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) me pretendime të njëjta si në kërkesen për rishqyrtim.

Përgjigje në Pretendimet e OE ANKUES

OE, ankues në ankesën e parashtruar në OSHP ka ngritë vetëm një pretendimin ankimor i cili paraprakisht është trajtuar përmes PSH; 2024/0202, të lëshuar me datë; dt 27.05.2025, me ç'rast pretendimet janë konsideruar si të bazuara, dhe nga AK ishte kërkuar që për aktivitetin e prokurimit të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës duke e kthyer lëndën në ri-vlerësim.

Konstatimet për papërgjegjshmërinë e OE ankues, të cilin tani e kundërshton përmes pretendimit ankimor, janë trajtuar në vendimin PSH 2025/0202 dt; 27/05/2025, Paneli e ka arsyetuar, papërgjegjshmërinë e OE ankues, për faktin se i njëjti nuk ka ofruar ndonjë dëshmi siç është procesverbali i nënshkruar në mes AK dhe OE përmes të cilit do të vertetohej koha e sakt e dorëzimit të sigurisë së tenderit tek AK. Vlenë të ceket fakti se një provë të tillë siç është procesverbali i dorëzimit të sigurisë së tenderit, në formë fizike nga ana e OE ankues tek AK, nuk është prezantuar nga asnjëra palë, as në kërkesen për ri-shqyrtim apo në arsyeshmerinë e vendimit përmes të cilit AK ka refuzuar kërkesen për ri-shqyrtim si të pabazuar. Andaj vlerësojmë se në rastin konkret, çështja sa i përket pretendimit ankimor të trajtohet si " Res- Judicata" konform nenin 16 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2022 paragrafi 2, pasi që pretendimi ankimor është i njëjtë me atë të shqyrtuar nga Paneli Shqyrtues me vendimin numer 2025/0202 dt. 27.05.2025.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që lënda të trajtohet si çështje e gjykuar sipas vendimeve paraprake të OSHP-së.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "GETNO L.L.C.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me AD-BLUE" me numër të prokurimit: "TU-24-9473-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – N.P.K. " TRAFIKU URBAN " SH.A.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **N.P.K. " TRAFIKU URBAN " SH.A.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **GETNO L.L.C.**



Fatmir Krasniqi